



**Lulzim KADRIU**  
**Skënderaj**

**Rasti Nr. 2019/41**  
**Ref:1907/950/KPM/mf**

### **VENDIM**

**Lidhur me Rastin Nr. 2019/41 – Lulzim KADRIU (Palë Ankuese) kundër KTV -së**

---

#### **Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 16 maj 2019 ka pranuar një ankesë nga ana e z. Lulzim Kadriu ndaj KTV-së me pretendimin për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
3. KPM me datën 16 maj 2019 ka pranuar një ankesë nga z. Lulzim Kadriu ndaj KTV-së për transmetim të kronikës “Ish-drejtori në Skënderaj, Kadriu, i dënuari për korrupsion, drejtor i Zyrës Ligjore në Ministrinë e Inovacionit”, të transmetuar në KTV më 16 maj 2019, përmes së cilës z. Kadriu pretendon se KTV ka shpifur ndaj tij, duke emetuar lajmin sipas tij të pavërtetë, se është i dënuar nga Gjykata Themelore për veprën penale të korrupsionit.
4. KPM ka analizuar ankesën e z. Kadriu dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 17 qershor 2019 ka gjetur se KTV nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

#### **Analiza ligjore**

5. Komisioni bazuar në faktet dhe analiza e lartpërmendura konstaton se KTV nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.



6. Komisioni pretendimet e Palës ankuese i ka trajtuar në kuptimin e nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 7, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënieve politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”*

7. KPM gjatë monitorimit ka gjetur se në kronikën ndaj të cilës është bërë ankesë, KTV ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. KTV kronikën e ka të balancuar, fillon me titullin që përmendet i dënuari për korrupsion, mirëpo përgjatë kronikës e sqaron se për çfarë ishte dënuar saktësisht Pala ankuese, duke u bazuar në vendimin e organeve kompetente. KTV kishte kontaktuar edhe vetë Palën ankuese, i cili nuk ishte përgjigjur, mirëpo ishte deklaruar avokati i tij.

Neni 7, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

*“OSHM-të respektojnë të drejtën e individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente.”*

8. KPM duke marrë parasysh faktin se edhe vet Pala ankuese e konfirmon se ka një Aktgjykim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë e që është vërtetuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, ku është shpallur fajtor për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, gjen se çështja e trajtuar nga KTV është në interes të publikut dhe KTV ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
9. KPM bazuar në të gjeturat e monitorimit ka gjetur se KTV nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të kronikës “Ish-drejtori në Skënderaj, Kadriu i dënuari për korrupsion, drejtor i Zyrës Ligjore në Ministrinë e Inovacionit.”
10. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se KTV kundër të cilës është ankuar Pala ankuese është në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM-2016/03.

### Vendim

11. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat lartpërmendura konstaton se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
12. Ankesa e z. Kadriu përmes së cilës pretendohet se KTV i ka cenuar të drejtat individuale me qëllim të denigrimit të personalitetit të tij, refuzohet si e pabazuar.

### E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
\_\_\_\_\_  
Muja FERATI  
Kryetar



30.07.2019.  
Datë